



Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini”

Ndryshime dhe plotësime

**RREGULLORE
PËR PUBLIKIMET E UNIVERSITETIT TË MITROVICËS “ISA BOLETINI”**

Mitrovicë
Shtator, 2018



UNIVERSITETI I MITROVICËS

UNIVERSITY OF MITROVICA

"ISA BOLETINI"

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
<http://www.umib.net>; Tel: +381-28535725/535727

Rektor i UMIB-it
Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 1329
Dt 05.10.2018

Në bazë të nenit 211 të Statutit, Senati i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", në mbledhjen e mbajtur më 10.9.2018, mori:

VENDIM

Për Ndryshime dhe plotësimë në

RREGULLOREN PËR PUBLIKIMET E UNIVERSITETIT TË MITROVICËS "ISA BOLETINI" Nr. prot. 409, dt. 20.04.2015

Neni 1

1. Në nenin 12 të Rregullores bazë, paragrafi 12.1 riformulohet me tekstin si në vijim:
 - 12.1. Ballinën me ngjyra në të cilën përfshihen: Emri i Universitetit, emri i njësisë akademike, emri dhe mbiemri i/e autorit, titulli i tekstit, stema e Universitetit, vendi dhe viti i botimit.
2. Në nenin 12 të Rregullores bazë, paragrafi 12.2 riformulohet me tekstin si në vijim:
 - 12.2. Faqja e parë duhet të përbajë titullin e botimit në këndin e epërm të djathtë, kurse faqja e dytë është e zbrazët.
3. Në nenin 12 të Rregullores bazë, paragrafi 12.4 riformulohet me tekstin si në vijim:
 - 12.4. Faqja e katërt: Autorin, duke i përfshirë gradat akademike dhe titullin e botimit(tekstit), emrat e recensemëve, kryetarit të Këshillit Botues, redaktorit, botuesit (Universiteti i Mitrovicës) dhe në fund numrin e vendimit me këtë përbajtje: Këshilli Botues i Universitetit të Mitrovicës lejoi publikimin dhe përdorimin e këtij teksti me vendimin nr. _____ të datës _____.
4. Në nenin 12 të Rregullores bazë, paragrafi 12.5 riformulohet me tekstin si në vijim:
 - 12.5. Faqja e pestë: dedikimi.
5. Në nenin 12 të Rregullores bazë, paragrafi 12.5 shtohet pika 12.5.A me tekstin si në vijim:
 - 12.5. A. Faqja e gjashtë: përbajtja.
6. Në nenin 12 të Rregullores bazë, paragrafi 12.6 riformulohet me tekstin si në vijim:
 - 12.6. Pas përbajtjes, mund të pasojë parathënia në faqen numër tek (në anën e djathtë), shenjat dhe shkurtesat, teksti i publikimit, kurse pas tekstit - literatura, indeksi i emrave, indeksi i nocioneve dhe në faqen e fundit: emri dhe mbiemri i autorit, titulli i publikimit, emri dhe mbiemri i lektorit, i korrektorit, i redaktorit artistik, i realizuesit kompjuterik dhe i autorit të ilustrimeve.
7. Në nenin 12 të Rregullores bazë, paragrafi 12.10 riformulohet me tekstin si në vijim:
 - 12.10. Formati i botimeve të Universitetit është B5 (17 x 24 cm). Radhitja duhet të bëhet sipas fontit Times New Roman, me madhësi të shkronjave 12, me rrallor 1.0.

Neni 2

1. Pas Nenit 12 të rregullores bazike shtohet nenit 12. A me tekstin si në vijim:

Neni 12.A

12.A.1. Dizajni i ballinës së librit (neni 12) është pjesë përbërëse e rregullores (shtojca I).

12.A.2. Autori dizajnit e merr në formë elektronike nga Universiteti dhe nuk lejohet të pësojë asnjë ndryshim.

Neni 3

1. Në nenin 18 të Rregullores bazë, paragrafi 18.2 riformulohet me tekstin si në vijim:

18.2. Pas botimit, në rastet kur publikimi mbështetet finansiarisht nga UMIB- i, botuesi është i obliguar t'ia dorëzojë:

- a). autorit të publikimit -10 kopje;
- b). rektoratit - 5 kopje;
- c). bibliotekës së njësisë akademike përkatëse 10 kopje;
- d). Bibliotekës Kombëtare të Kosovës 5 kopje;
- e). Bibliotekës së Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini” 5 kopje,
- f). Bibliotekës së Mitrovicës “Latif Berisha” 5 kopje.

Në nenin 18 të Rregullores bazë, paragrafi 18.3 riformulohet me tekstin si në vijim:

18.3. Në rastet kur publikimet universitare botohen me vetëfinancim ose bashkëfinancim, autorit është i obliguar t'ia dorëzojë:

- a) rektoratit - 5 kopje;
- b) Bibliotekës së njësisë akademike përkatëse 5 kopje;
- c) Bibliotekës Kombëtare të Kosovës - 3 kopje;
- d) Bibliotekës së Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini”- 5 kopje.
- e) Bibliotekës së Mitrovicës “Latif Berisha” 5 kopje.

Neni 4.

Ndryshimet dhe plotësimet në Rregullorë për publikimet e Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini” hyjnë në fuqi ditën e miratimit nga Senati i Universitetit dhe janë pjesë përbërëse e Rregullores.

Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Rektor i UMIB-it



Shtojca I



Font: Arial Bold, Madhësia 20 pt

Emri Mbiemri, Titulli i botimit universitar

Titulli i bottimit universitar

Font: Times New Roman
Madhësia 24 pt



Njëjja e logo-s
CMYK: 78C/55M/0Y/35K
RGB: #228B22
Madhësia 4cm

Emri Mbiemri
Font: Arial Bold
Madhësia 12 pt

UNIVERSITETI I MITROVICËS "ISA BOLETINI"

FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKË DHE KOMPJUTERIKË

Font: Arial Bold
Madhësia 18 pt
Trashecia 4 pt

Font: Arial Bold
Madhësia: 18 pt ndersa Object Size është 0.55 cm
Trashecia 8 pt